

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr./Br./No. 1220	Nr./faq./Br. str./No. pg 20	
Data / Datum / Date: 13.05.2026		



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

Këshilli Drejtues i Universitetit

Pejë, \_\_.5.2026

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mbështetur në nenet 17, 22 dhe 23 të Statutit Nr. 04-V-622, datë 30.5.2013, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.4.2026, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet Rregullorja për të ardhurat dhe kompensimin e personelit akademik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Dokumenti i plotë i rregullores së miratuar është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushojnë së vlejture dispozitat e Rregullores me nr. 3162, datë 2.11.2023 për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat dhe kompensimet tjera.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Këshilli Drejtues i UHZ:

  
Prof. Ass. Dr. Emine Abdylë, kryesuese



**T'u dërgohet:**

- Anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Zyrës së Rektorit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Njësive akademike;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës për Buxhet dhe Financa;
- Zyrës së Teknologjisë së Informacionit;
- Zyrës për Protokoll dhe Arkiv.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / E / No. <b>1220</b>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <b>19</b>	
Data / Datum / Date: <b>13.05.2026</b> Pajë / Poč		

## RREGULLORE

PËR TË ARDHURAT DHE KOMPENSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË  
UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA"

Pejë, prill 2026.

## PËRMBAJTJA

<b>RREGULLORE PËR TË ARDHURAT DHE KOMPENSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK.....</b>	<b>3</b>
<b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSME .....</b>	<b>3</b>
Neni 1 Qëllimi.....	3
Neni 2 Fushëveprimi .....	3
Neni 3 Burimet e financimit.....	3
Neni 4 Përkufizimet dhe shkurtesat .....	4
Neni 5 Planifikimi i shpenzimeve për kompensimin e personelit akademik .....	5
Neni 6 Kufizimet në marrëdhënien e punës me normë të plotë dhe kompensimi .....	5
<b>II. KOMPENSIMI I PERSONELIT AKADEMIK NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE.....</b>	<b>6</b>
Neni 7 Kompensimi i personelit akademik në kuadër të marrëdhënies së punës .....	6
Neni 8 Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik .....	6
Neni 9 Kompensimi i personelit akademik për orët dhe angazhimet shtesë.....	8
<b>III. KOMPENSIMI PËR PERSONELIN E ANGAZHUAR.....</b>	<b>9</b>
Neni 10 Angazhimi dhe kompensimi i personelit akademik me kontratë jo të rregullt .....	9
Neni 11 Angazhimi për mësimdhënie i personelit akademik të UHZ, pas pensionimit .....	9
Neni 12 Angazhimi dhe kompensimi i profesorit me titullin “Profesor Emeritus” .....	9
Neni 13 Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UHZ .....	10
Neni 14 Kompensimi i profesorëve vizitorë .....	10
Neni 15 Kompensimi i ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike .....	11
Neni 16 Kompensimi në studimet e doktoratës .....	12
<b>IV. KOMPENSIMI PËR POZITAT MENAXHUESE DHE FUNKSIONET TJERA .....</b>	<b>12</b>
Neni 17 Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe funksionet tjera në nivel të UHZ-së dhe në njësi akademike.....	12
Neni 18 Përcaktimi i grupeve në studime (për ligjërata dhe ushtrime) me qëllim të kompensimit.....	13
<b>V. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT .....</b>	<b>13</b>
Neni 19 Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura .....	13
Neni 20 Ndalesa për mospërbushje të detyrave të punës .....	15
Neni 21 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare .....	15
Neni 22 Hyrja në fuqi.....	16



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

Këshilli Drejtues i Universitetit

Pejë, \_\_.4.2026

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, nën-nënparagrafi 1.6.2. të Statutit të Universitetit të Universitetit "Haxhi Zeka", Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka", në mbledhjen e mbajtur më 29.4.2026, miratoi:

**RREGULLORE**

**PËR TË ARDHURAT DHE KOMPENSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSME**

**Neni 1 [Qëllimi]**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat e kompensimit të personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar në Universitetin "Haxhi Zeka", përfshirë edhe shtesat për ushtrimin e funksioneve përkatëse, shërbimin në komisionet e specifikuar në këtë rregullore, kompensimin e punës punën shtesë dhe aspektet apo çështjet tjera e tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ndikojnë në të ardhurat personale të personelit akademik, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të UHZ.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë të punësuarit në Universitetin "Haxhi Zeka", në cilësinë e personelit akademik, qofshin ata me marrëdhënie të rregullt pune apo në bazë të një marrëveshjeje kontraktuale për angazhim.

**Neni 3  
Burimet e financimit**

1. Në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe dispozitat e Statutit, Universiteti "Haxhi Zeka", ka të drejtë të pranojë fonde nga këto burime:
  - 1.1. Alokimet nga Ministria e Financave, për mësim, kërkime shkencore dhe punë artistike me interes të përgjithshëm në bazë të buxhetit të miratuar;
  - 1.2. Tarifat për shkollim dhe pagesat tjera të paguara nga studentët;

- 1.3. Pagesat për shërbime komerciale dhe shërbimet tjera;
- 1.4. Donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
- 1.5. Kontratat me organet vendore, ndërkombëtare, publike dhe private, për mësimdhënie, kërkime shkencore, punë artistike dhe këshillime apo ekspertiza.

#### Neni 4 Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Për nevoja të kësaj rregulloreje, shprehjet dhe shkurtesat e mëposhtme kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **MASh** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
  - 1.2. **UHZ** - Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë;
  - 1.3. **Bashkëpunëtor i jashtëm** – Mësimdhënësi/ja, lektori/ja ose asistenti/ja i/e angazhuar, në marrëdhënie jo të rregullt pune me UHZ-në, me një fond të caktuar orësh dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi të UHZ-së. Kjo përfshin edhe personelin e angazhuar përmes bashkëpunimeve me ambasada, agjenci shtetërore dhe organizata ndërkombëtare, si dhe ekspertë që mbajnë orë praktike/klinike sipas programeve të akredituara, në bazë të marrëveshjeve që ka UHZ-ja ose njësitë akademike, respektivisht bazuar në rregulloren në fuqi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UHZ.
  - 1.4. **Normë e plotë** - Nënkupton fondin e orëve mësimore për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, e cila pasqyrohet edhe në kontratën e punës;
  - 1.5. **Punë shtesë** - Punë ose angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë, në rastin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ;
  - 1.6. **Koeficienti i pagës apo koeficienti** - Nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion;
  - 1.7. **Legjislacioni në fuqi** – Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, nënkupton: Ligjin në fuqi për Zyrarët Publik; Ligjin në fuqi për Pagat në Sektorin Publik; Ligjin në fuqi për Arsimin e Lartë; Statutin dhe aktet e tjera në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
  - 1.8. **Paga bazë** - nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;
  - 1.9. **Pagë shtesë** - Pagë shtesë në përqindje të pagës bazë e cila i takon personelit akademik për punën më të gjatë se orët e përcaktuara me normë të plotë dhe për punë gjatë fundjavës;
  - 1.10. **Shtesë funksionale** - Shtesa funksionale, e cila i takon personelit akademik për ushtrimin e funksionit përkatës, siç parashihet në legjislacionin e zbatueshëm, në Statutin dhe aktet e tjera të UHZ-së;
  - 1.11. **Funksionar publik** – Nënkupton funksionarin/en publik/e sipas përcaktimeve të legjislacionit për zyrarët publikë në fuqi.
  - 1.12. **Profesor vizitor/i ftuar** - Nënkupton mësimdhënësin e angazhuar nga një universitet dhe institucion tjetër ndërkombëtar i arsimit të lartë;

- 1.13. “Profesor Emeritus”** – Titull i cili sipas përcaktimeve të Statutit, i caktohet nga Senati profesorit të pensionuar të UHZ, për arritje të veçanta akademike dhe shkencore gjatë periudhës së aktivitetit të tij.

#### **Neni 5**

##### **Planifikimi i shpenzimeve për kompensimin e personelit akademik**

1. Universiteti “Haxhi Zeka”, në koordinim me njësitë akademike dhe trupat e tjerë brenda UHZ-së, bën planifikimin e buxhetit vjetor për të mbuluar koston e kompensimit të personelit në marrëdhënie të rregullt pune dhe të angazhuar. Mjetet për kompensimin e personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar, planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor të miratuar të UHZ-së.
2. Shuma e të ardhurave dhe kompensimeve të tjera caktohet në bazë të koeficientëve dhe thirrjeve, sipas kodimit unik për të gjithë nëpunësit publik të arsimit në Kosovë.
3. Njësia përgjegjëse për financat në UHZ, bën përllogaritjen e të ardhurave dhe kompensimeve të tjera bazuar në vendimet dhe kontratat e nënshkruara me personelin akademik të UHZ-së. Mbi këtë bazë, menaxhmenti jep urdhër për realizmin e pagesave sipas vendimeve dhe kontratave që lidhen me personelin akademik të punësuar dhe të angazhuar.
4. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, gjatë çdo viti buxhetor, UHZ-ja në bashkëpunim me njësitë akademike dhe mekanizmat e tjerë të përcaktuar sipas rregulloreve në fuqi, bën planifikimin buxhetor për punësimin e personelit akademik të ri, riemërimin dhe avancimin e personelit ekzistues, si dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe personelit tjetër.

#### **Neni 6**

##### **Kufizimet në marrëdhënien e punës me normë të plotë dhe kompensimi**

1. Personeli i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ nuk mund të ketë një kontratë tjetër pune me normë të plotë në një universitet apo institucion tjetër. Personeli akademik mund të jetë i angazhuar në institucione tjera në cilësi të ekspertit, konsulentit apo në trupa të tjerë në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.
2. Kriteret për kufizimet mbi angazhimet shtesë të personelit akademik në një institucion tjetër, qoftë brenda apo jashtë vendit, përcaktohen nga legjislacioni i zbatueshëm dhe vendimet relevante të Këshillit Drejtues.
3. Personeli akademik që mban pozitën e deputetit në Kuvendin e Kosovës, bazuar në legjislacionin në zbatim, kompensohet vetëm me rastin e angazhimit në proces mësimor, deri në 20% të pagës bazë, në përputhje me thirrjen akademike që mban.
4. Personeli akademik, që mban një pozitë publike tjetër në Republikën e Kosovës, i pezulluar sipas legjislacionit të zbatueshëm, kompensohet vetëm për orët e mbajtura, bazuar në këtë rregullore.

## **II. KOMPENSIMI I PERSONELIT AKADEMIK NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE**

### **Neni 7**

#### **Kompensimi i personelit akademik në kuadër të marrëdhënies së punës**

1. Personeli akademik me marrëdhënie të rregullt pune, punësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet për emërim sipas titullit akademik të përcaktuar në Statut dhe në aktin e brendshëm të UHZ-së.
2. Në rastet kur kontrata e punës për personelin akademik skadon, ndërsa konkursi nuk është publikuar, respektivisht përmbyllja e tij është vonuar për shkaqe objektive jashtë vullnetit dhe kontrollit të tij/saj, kontrata ekzistuese vazhdohet automatikisht dhe me të njëjtat kushte, me vendim të veçantë të rektorit, deri në përmbylljen e procedurave të konkursit (riemërimin apo avancimin).
3. Për personelin e rregullt akademik me kontratë pune me normë të plotë (40 orë në javë), në detyrimet e punës përfshihen:
  - 3.1. Përgatitja dhe zhvillimi i ligjëratave dhe ushtrimeve në njësinë/njësitë akademike ku personeli është i punësuar, në përputhje me normën e përcaktuar në tabelën 1 të kësaj rregulloreje;
  - 3.2. Mbikëqyrja (mentorimi) i punimeve të diplomës në nivelin bachelor dhe master. Për nivelin master deri në normën e përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje;
  - 3.3. Pjesëmarrja në komisione akademike brenda njësisë akademike, duke përfshirë komisionet e punimeve të nivelit bachelor dhe master;
  - 3.4. Organizimi dhe mbajtja e provimeve dhe konsultimeve me studentë;
  - 3.5. Angazhimi në procesin e akreditimit të programeve të studimit të njësisë akademike;
  - 3.6. Angazhimi në zbatimin e procedurave të konkurseve për pranimin e studentëve në programet bachelor, master dhe doktoratë;
  - 3.7. Pjesëmarrja në takimet e organeve kolegjiale: këshilli i njësisë akademike, komisionet e themeluara nga njësia akademike, departamentet e njësisë akademike dhe trupat tjerë;
  - 3.8. Kryerja e detyrave dhe angazhimeve të tjera akademike në kuadër të njësisë akademike, në të cilën është zgjedhur, siç përcaktohet në aktet normative të UHZ-së dhe kontratën e punës.
4. Kompensimi i personelit akademik për angazhimet sipas normës së plotë, si dhe për detyrat dhe përgjegjësitë shtesë, bëhet në përputhje me vendimet e organeve kompetente të UHZ-së, të nxjerra sipas kësaj rregulloreje si dhe kontratave individuale të lidhura ndërmjet UHZ-së dhe personelit akademik.

### **Neni 8**

#### **Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik**

1. Kompensimi i personelit të rregullt akademik për punën me orar të plotë konsiderohet me kohëzgjatje prej dyzet (40) orësh, sipas akteve ligjore në fuqi dhe Opinionit Ligjor me numër reference 214/2023, datë 18.7.2023 të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, caktohet norma e plotë e orëve javore të mësimdhënies sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, niveli i pagës sipas titullit akademik, si dhe detyrat përkatëse të përfshira në normën e rregullt.
3. Për orët shtesë, që tejkalojnë normën e plotë javore, personeli akademik ka të drejtë për kompensim shtesë, të llogaritur në përqindje të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas kësaj rregulloreje.
4. Norma e plotë e orëve javore të mësimdhënies dhe pagesa përkatëse përcaktohen si më poshtë:

**Tabela nr. 1.**

Nr.	Titulli akademik	Norma e plotë e orëve javore të mësimimit	Koeficienti <sup>1</sup>		Paga bazë (€)	
			Janar 2025	Korrik 2025	Janar 2025	Korrik 2025
1.	Profesor i rregullt	6 (gjashtë)	12.9	13.4	1,419.00	1,474.00
2.	Profesor i asociuar	6 (gjashtë)	11.9	12.4	1,309.00	1,364.00
3.	Profesor asistent	6 (gjashtë)	10.9	11.4	1,199.00	1,254.00
4.	Lektor	10 (dhjetë)	8.0	8.5	880.00	935.00
5.	Korepetitor	10 (dhjetë)	8.0	8.5	880.00	935.00
6.	Asistent	10 (dhjetë)	7.7	8.2	847.00	902.00

5. Në rastet kur personelit akademik me thirrjen “Profesor” i cenohet realizimi i normës së rregullt të ligjëratave, për qëllime kompensimi, atyre u lejohe mbajtja deri në dy (2) orë ushtrime brenda semestrit, me qëllim të përmbushjes së orëve mësimore për normë të rregullt, si në kontratën individuale të punës.
6. Kusht për shpalljen e konkursit për pozita të reja për personel të rregullt akademik (profesor, asistent, lektor dhe korepetitor), është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër në lëndët zgjedhore. Norma e plotë llogaritet për një vit akademik.
7. Asistentët e rizgjedhur, të autorizuar për ligjëratave të kufizuara në nivelin bachelor, në përputhje me Statutin e UHZ-së, kompensohen për orët e mbajtura si ushtrime, bazuar në pagën bazë.
8. Llogaritja dhe kompensimi për përvojën e punës realizohet në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikën e Kosovës, mbi pagën bazë për pozitë të caktuar.

<sup>1</sup> Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Vlera e koeficientit apo koeficienti do të ndryshojë me automatizëm sipas vendimeve të Qeverisë/Kuvendit.

## Neni 9

### Kompensimi i personelit akademik për orët dhe angazhimet shtesë

1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, ka të drejtë për kompensim shtesë për çdo orë mësimore të mbajtur jashtë normës së plotë, në bazë të shtojcës 1 dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune, i takon kompensim shtesë për çdo angazhim shtesë që nuk është përfshirë në detyrat e punës, të përcaktuara me nenin 7 të kësaj rregulloreje dhe që përbën funksion shtesë, bazuar në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe akteve tjera në fuqi.
3. E drejta për kompensim shtesë zbatohet deri në kufirin prej 30% të pagës bazë dhe në proporcion me numrin e orëve të punës shtesë. Llogaritja e kompensimit për orët shtesë dhe detyrat e tjera, siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni, bazohet në lartësinë e pagës bazë sipas thirrjes akademike.
4. Këshilli i njësisë akademike, para fillimit të çdo viti akademik përkatës, identifikon dhe vërteton nevojat për angazhimin e personelit të rregullt akademik me orë shtesë pune, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, me qëllim parandalimin e vonesave në fillimin me kohë të vitit akademik.
5. Këshilli i njësisë akademike paraqet kërkesë për miratimin e angazhimit të personelit akademik me orë shtesë, të paktën dyzet e pesë (45) ditë kalendarike para fillimit të vitit të ri akademik, respektivisht para fillimit të semestrit veror (në rastet kur angazhimi kufizohet vetëm në këtë semestër). Përrjashtimisht, ky afat nuk zbatohet në raste rrethanash të paparashikueshme, që janë jashtë kontrollit dhe pavarësisht vullnetit të institucionit
6. Rektori, si autoriteti kryesor menaxhues, nxjerr vendim për kërkesën e njësisë akademike sipas paragrafit 5 të këtij neni, brenda pesë (5) ditëve nga data e pranimit të saj.
7. Përveç orëve mësimore, punë shtesë do të konsiderohen edhe orët e angazhimit që tejkalojnë normën e përcaktuar për detyrat dhe përgjegjësitë tjera, sipas Shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, siç specifikohet më poshtë:
  - 7.1. Mentorimi i temave të masterit brenda një viti akademik;
  - 7.2. Pjesëmarrja në komisione, trupa profesionale dhe kryerja e detyrave shtesë të përcaktuara nga organet e Universitetit “Haxhi Zeka”, përfshirë këshillin drejtues, rektorin dhe senatin.
8. Për angazhimin e personelit akademik të rregullt në detyra jashtë njësisë akademike, përfshirë pjesëmarrjen në komisione apo trupa në nivel të Universitetit “Haxhi Zeka”, sipas shtojcës 1, të cilat nuk bëjnë në përshkrimin e detyrave të punës të përcaktuara në këtë rregullore, universiteti mund të kompensojë personelin për këto detyra shtesë, nëse ato janë aprovuar paraprakisht nga Këshilli drejtues, Senati apo Rektori/ja, përmes një vendimi përkatës. Kompensimi për detyrat shtesë bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin për pagat në sektorin publik.

9. Orët shtesë të punës nuk mund të transferohen nga një semestër në tjetrin. Për të caktuar dhe kompensuar orët shtesë, duhet të jetë përmbushur paraprakisht norma e plotë për vitin akademik. Pasi të jetë përmbushur norma e plotë për personelin në kuadër të programit apo departamentit (për mësimdhënësit me ligjërata dhe asistentët me ushtrime), orët e mbetura mund të kompensohen si orë shtesë.
10. Për ushtrimin e funksioneve dhe lidhur me angazhimin shtesë, si në përcaktimet e Shtojcës 1, të drejtën e kompensimit e ka edhe personeli jo akademik, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe legjislacionin për pagat në sektorin publik.

### **III. KOMPENSIMI PËR PERSONELIN E ANGAZHUAR**

#### **Neni 10**

#### **Angazhimi dhe kompensimi i personelit akademik me kontratë jo të rregullt**

1. Universiteti “Haxhi Zeka”, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe bazuar në nevojat akademike, ka të drejtë të angazhojë për një periudhë të caktuar dhe kompensojë personel akademik, sipas përcaktimeve:
  - 1.1. Personeli akademik i pensionuar i UHZ-së, me të drejtë angazhimi deri në moshën 70-vjeçare (sipas vendimit përkatës të Qeverisë);
  - 1.2. Profesorë Emeritus;
  - 1.3. Bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime;
  - 1.4. Profesorë vizitorë;
  - 1.5. Ekspertë për mbajtjen e orëve klinike/praktike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike;
  - 1.6. Anëtarë të jashtëm në komision dhe mbrojtje të doktoratës.

#### **Neni 11**

#### **Angazhimi për mësimdhënie i personelit akademik të UHZ, pas pensionimit**

1. Personeli akademik i pensionuar i UHZ-së, mund të angazhohet për mësimdhënie deri në gjashtë (6) orë në javë, në varësi të titullit akademik, me të drejtë të kompensimit për orë pune në lartësi të përqindjes (%) së kompensimit shtesë për orë pune të personelit në marrëdhënie të rregullt pune, sipas specifikimit në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.
2. Angazhimi i kësaj kategorie të personelit bëhet bazuar në nevojat e njësive akademike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, deri në plotësimin e pozitës me personel të rregullt.

#### **Neni 12**

#### **Angazhimi dhe kompensimi i profesorit me titullin “Profesor Emeritus”**

1. Profesori i pensionuar universitar, të cilit i është caktuar titulli i nderit “Profesori Emeritus”, ka të drejtën të japë mësim dhe të merret me punë shkencore në pajtim me kualifikimet e tij dhe kërkesat e njësisë së veçantë akademike deri në moshën 70-vjeçare, derisa titulli formal i “Profesorit Emeritus” është i përhershëm.

2. Profesori universitar të cilit i është caktuar titulli “Profesor Emeritus” nga Senati, përfiton shtesë mujore prej 20% të pagës bazë të profesorit të rregullt.
3. Çështjet tjera rreth të drejtave dhe përgjegjësiive të “Profesorit Emeritus” caktohen me kontratë individuale të lidhur nga rektori me propozimin e dekanit të njësisë së veçantë akademike.

### **Neni 13**

#### **Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UHZ**

1. Bashkëpunëtorëve të jashtëm u takon kompensimi deri në 6 orë në javë, në përputhje me përcaktimet e shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm kanë të drejtë për kompensim për një periudhë që nuk tejkalon tetë (8) muaj brenda vitit akademik, bazuar në orët e realizuara, siç përcaktohet në këtë rregullore.
3. Në raste të mosparaqitjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me aktin e brendshëm për rregullimin e procedurave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ligjërata në nivelin e studimeve баçelor në Fakultetin e Arteve mund të angazhohen edhe kandidatët me gradën Master i Shkencave (MSc.) ose ekuivalente me të dhe Master i Arteve (MA), sipas Statutit dhe akteve të brendshme të UHZ-së.
4. Pagesa për kategorinë nga paragrafi 3 të këtij neni do të bëhet në lartësinë e pagesës së përcaktuar për bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime.
5. Orët mësimore për bashkëpunëtor të jashtëm, nuk mund të tejkalojnë fondin orëve për ligjërata dhe ushtrime të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, me përjashtim të rasteve kur kjo lejohet nga Senati, për arsye të vlefshme.

### **Neni 14**

#### **Kompensimi i profesorëve vizitorë**

1. Profesorët vizitorë angazhohen me propozim të Këshillit të njësisë akademike dhe miratim përfundimtar të Senatit. Angazhimi i tyre mund të realizohet vetëm pas planifikimit paraprak nga njësia akademike përkatëse, para fillimit të vitit akademik.
2. Kompensimi i profesorëve vizitorë kryhet pas realizimit të angazhimit të tyre, në përputhje me rregulloren përkatëse për bashkëpunëtorët e jashtëm dhe sipas përcaktimeve në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
3. Profesorëve vizitorë nuk mund t’u kompensohen më shumë se njëzet e katër (24) orë gjatë një muaji. Këto orë mund të mbahen sipas sistemit bllok, por jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda një dite pune.
4. Profesorit vizitor nga vendet jashtë rajonit i mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit, por vetëm një (1) biletë kthyesë, sipas çmimit ekonomik dhe të arsyeshëm.

5. Në rastet kur UHZ, ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit me universitetet tjetër, në të cilin parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorit/ëve vizitor/ë për një cikël të kufizuar ligjëratash dhe nëse shkëmbimi është në përmasa afërsisht të barabarta për të dy institucionet, kërkesa përkatëse nga njësia akademike mund të paraqitet në çdo kohë dhe nuk kërkon miratim në Senat. Shpenzimet lidhur me vizitat e tilla mbulohen nga universiteti dërgues ose nga universiteti pritës, varësisht nga përcaktimet e marrëveshjes
6. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit sipas paragrafit 5 të mbulohet nga institucioni pritës, UHZ mbulon kompensimin deri në gjashtë (6) orë ligjërata, siç përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në vlerën e kompensimit dhe sipas procedurës së përcaktuar me akt të Qeverisë, për shpenzime jashtë vendit, respektivisht sipas tarifave për vendin e institucionit me të cilin ekziston marrëveshja sipas paragrafit 3 të këtij neni.
7. Nëse marrëveshja parasheh që kompensimi i shpenzimeve të shkëmbimit sipas paragrafit 5 të mbulohet nga institucioni dërgues, UHZ, do të kompensojë personelin e vet për deri në gjashtë (6) orë të mbajtura. Të gjitha shpenzimet e tjera shoqëruese (udhëtim, akomodim, ushqim) paguhen sipas akteve në fuqi për këtë qëllim. Shpenzimet totale nuk mund të tejkalojnë shumën prej 1,000.00 € (njëmijë euro) bruto për një profesor vizitor dhe paguhen mbi pagën e rregullt që ai/ajo merr në UHZ.
8. UHZ, i mbulon për personelin e vet të gjitha shpenzimet sipas paragrafit 5, në rastet kur ekziston marrëveshje mirëkuptimi me universitetin pritës, me të cilën parashihet shprehimisht shkëmbimi i profesorëve vizitorë.
9. Një profesor i UHZ-së, nuk mund të qëndrojë në cilësinë e profesorit vizitor më shumë se një (1) herë në të njëjtin universitet dhe për lëndë të njëjta. Qëndrimi i përsëritur në të njëjtin universitet, por për lëndë të ndryshme, lejohet vetëm nëse nuk ka të interesuar të tjerë (pavarësisht thirrjes akademike).
10. Rektori i UHZ-së nxjerr vendim për secilin profesor vizitor të njëjësive akademike në të cilin specifikohen përgjegjësitë dhe obligimet përkatëse.
11. Buxheti për profesorët vizitorë miratohet nga Këshilli drejtues, pas propozimit të rektorit, ndërsa rishikohet në intervale të caktuara vjetore (së paku dy herë në vit – para fillimit të semestrit akademik).
12. Me kërkesë të arsyetuar nga rektori, skema e përfituesve nga radhët e profesorëve vizitorë mund të zgjerohet nga Këshilli drejtues me vendim të veçantë, por brenda lartësisë së buxhetit të aprovuar për vitin përkatës.

#### **Neni 15**

#### **Kompensimi i ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike**

1. Ekspertëve të praktikës, sipas programeve të akredituara, gjithashtu u takon kompensim në këtë kategori, bazuar në marrëveshjet e arritura nga UHZ-ja ose njësitë akademike me

institucionet publike përkatëse. Lartësia e kompensimit për këtë kategori përcaktohet në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

2. Kompensimi i ekspertëve të praktikës, të angazhuar për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, realizohet në përputhje me marrëveshjet e arritura nga universiteti ose njësitë akademike, në lartësi dhe për fond të përcaktuar të orëve si shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.
3. Fondi i orëve për ekspertët e praktikës përcaktohet në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 16**

#### **Kompensimi në studimet e doktoratës**

1. Orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten si orë shtesë sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.
2. Në rastet kur personeli akademik nuk ka orë të mjaftueshme të mbajtura në nivelet e tjera të studimeve, orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten si pjesë e normës së rregullt.
3. Anëtarët e jashtëm të komisionit për mbrojtjen e disertacionit doktoratës kompensohen për ekspertizën e dhënë gjatë procesit të vlerësimit, në përputhje me përcaktimet si në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

#### **IV. KOMPENSIMI PËR POZITAT MENAXHUESE DHE FUNKSIONET TJERA**

#### **Neni 17**

#### **Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe funksionet tjera në nivel të UHZ-së dhe në njësi akademike**

1. Personeli akademik, përfiton shtesë funksionale për ushtrimin e funksioneve të caktuara. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të bartësit të funksionit.
2. Në rastin kur i zgjedhuri, gjatë ushtrimit të funksioneve si rektor/e, prorektor/e, dekan/e dhe prodekan/e, pezullon angazhimet si personel akademik, aplikohet koeficienti i pagës sipas përcaktimit të shtojcës përkatëse të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.
3. Në rastin kur i zgjedhuri, gjatë ushtrimit të ndonjërit prej funksioneve si në paragrafin 2, nuk pezullon angazhimin si personel akademik, përfiton shtesë funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës, e cila nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë.
4. Nëse nuk parashihet ndryshe me akt të posaçëm, lartësia e kompensimit për anëtarët e Këshillit Drejtues, pa përjashtim, bëhet si në vijim:
  - 4.1. Kryesuesi, në masën tridhjetë për qind (30%) të pagës bazë të Zyrtarit Kryesor Administrativ;
  - 4.2. Anëtari, në masën njëzet për qind (20%) të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

5. Për pozita dhe funksione të tjera shtesë (përveç atyre të përmendura më lart), personeli akademik përfiton kompensime sipas rregullave të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe akteve nënligjore përkatëse, duke u mbështetur në listën e detajuar si në shtojcën Nr. 1 të kësaj rregulloreje.
6. Pavarësisht numrit të funksioneve shtesë, bartësi nuk mund të kompensohet më shumë se 20% të pagës bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës për pagat në sektorin publik. Njësia përgjegjëse për financat, është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e këtij kufizimi.

#### **Neni 18**

#### **Përcaktimi i grupeve në studime (për ligjërata dhe ushtrime) me qëllim të kompensimit**

1. Formimi i grupeve për ligjërata dhe ushtrime në njësi akademike, do të bëhet në përputhje me kuotën e numrit të studentëve, të lejuar me vendimet respektive të akreditimit/riakreditimit të programeve përkatëse.
2. Duke marrë parasysh implikimet financiare dhe për qëllime të kompensimit të orëve mësimore, formimi i grupeve të studimit dhe përcaktimi i numrit të studentëve për secilin grup miratohen nga Këshilli drejtues për çdo vit akademik, pas konsultimit me Senatin e Universitetit “Haxhi Zeka”.

### **V. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT**

#### **Neni 19**

#### **Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura**

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet përmes evidencës elektronike të pjesëmarrjes së studentëve, të gjeneruar nga platforma përkatëse elektronike, e verifikuar nga prodekani përgjegjës për çështje mësimore ose i autorizuar tjetër i dekanit të njësisë akademike përkatëse.
2. Listat fizike, mund të përdoren për të dëshmuar mbajtjen e orëve mësimore dhe për qëllime kompensimi, vetëm përjashtimisht dhe në rrethana të veçanta<sup>2</sup> kur evidentimi përmes sistemit elektronik është i parralizueshëm.
3. Arsyet për këtë, konfirmohen me shkrim nga prodekani përgjegjës për çështje mësimore për personelin akademik të njësisë akademike përkatëse, brenda ditës së pranimin të njoftimit nga Zyra për Teknologji të Informacionit.
4. Mbajtja e orëve mësimore në formatin online lejohet vetëm me vendim të Senatit/Këshillit të fakultetit dhe autorizim të Dekanit të njësisë akademike përkatëse (ose personit të autorizuar

---

<sup>2</sup> Në këtë rast “rrethanë e veçantë” konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike, problemet eventuale në SMU dhe pajisjet në salla (të cilat konstatohen nga Zyra për Teknologji të Informacionit), ndryshimi i sallave dhe të tjera të ngjashme. Në raste të tilla, duhet njoftuar nëpërmjet adresës zyrtare elektronike prodekani/ja përgjegjës për çështje mësimore dhe zyrtar/ja për çështje mësimore në njësi akademike.

nga dekani). Në këtë rast, orët konsiderohen të realizuara dhe kompensohen, vetëm nëse pjesëmarrja e studentëve vërtetohet bazuar në raportet e gjeneruara nëpërmjet regjistrit elektronik të platformës.

5. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm, nga profesorët vizitorë dhe ekspertët dhe orët shtesë të punës nga personeli i rregullt kompensohen në muajin vijues, bazuar në raporte të dorëzuara dhe verifikuara nga prodekani përgjegjës për çështje mësimore.
6. Raportet e verifikuara dhe nënshkruara nga prodekani përgjegjës për çështje mësimore duhet të dorëzohen për pagesë në shërbimin financiar të njësisë akademike përkatëse deri më datë 3 të muajit vijues. Nëse raportet e verifikuara për muajin paraprak nuk dorëzohen deri më datën 3 të muajit vijues (përfshirë ditët e pushimit), kompensimi nuk realizohet.
7. Raportet për orët e mbajtura, më të vjetra se një muaj, nuk kompensohen. Si përjashtim, kompensimi mund të realizohet në rast të evidentimit të gabimeve apo lëshimeve të bëra nga zyrtarët përkatës të njësisë akademike dhe Administratës Qendrore. Kërkesa e arsyetuar parashtrohet nga mësimdhënësi dhe shqyrtohet nga prodekani përgjegjës për çështje mësimore.
8. Në rastet e mosmbajtjes së orëve ose mosdorëzimit të raporteve të orëve sipas rregullave në fuqi, dekani/ja i/e njësisë akademike mund të shqiptojë ndalesa financiare, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
9. Ora mësimore në të cilën mësimdhënësi (profesori ose asistenti) ka qenë i pranishëm, por nuk ka marrë pjesë asnjë student, konsiderohet e vlefshme dhe e lejueshme për kompensim, me kushtin që prania e mësimdhënësit të dëshmohet përmes raportit elektronik ose fizik të aprovuar nga prodekani përgjegjës. Ky rregull aplikohet në rastin e lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore, me kushtin që mungesa e studentëve të mos tejkalojë 30% të orëve të parashikuara mësimore për lëndën.
10. Orët mësimore që bien gjatë festave zyrtare të përcaktuara me ligj duhet të zëvendësohen (në formë online ose fizike), sipas udhëzimeve të senatit apo keshillit të fakultetit.
11. Pagesat për orët e mbajtura realizohen në fund të muajit përkatës. Përjashtimisht, në rastet kur nuk ka mjete buxhetore në kategorinë përkatëse ekonomike, pagesa mund të shtyhet për muajt vijues.
12. Rektori/ja ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë verifikimin e mbajtjes së mësimin për çdo periudhë të caktuar, për çdo grup të caktuar të studentëve në njësitë akademike. Verifikimi realizohet në bazë të evidencave zyrtare, përfshirë listat elektronike ose fizike të studentëve. Ky proces kryhet me qëllim të monitorimit dhe mbikëqyrjes së menaxhimit të financave, duke siguruar që alokimi i fondeve për orët mësimore dhe proceset akademike të jetë në përputhje me planifikimin financiar dhe dispozitat ligjore.
13. Njësitë akademike obligohen të ofrojnë të gjitha dokumentet dhe evidencat e nevojshme brenda afateve të caktuara.

## Neni 20

### Ndalesa për mospërbushje të detyrave të punës

1. Për shkak të mospërbushjes së paarsyetuar të detyrave të punës, si: mosmbajtja e ligjëratave, ushtrimeve dhe provimeve, dekani/ja i/e njësisë akademike ka të drejtë të nxjerrë vendim për shqiptimin e ndalesës së kompensimit të personelit akademik prej 10 deri në 20% të pagës bazë. Rektori/ja mund të shqiptojë masa të tilla ndaj dekanëve dhe vartësve të tjerë në nivel të UHZ-së për arsyet e njëjta.
2. Për mospjesëmarrje të përsëritur në mbledhjet e organeve kolegjiale të njësive akademike, moskryerje të detyrave lidhur me mentorimin e punimeve të diplomës dhe të detyrave të tjera të parapara në kontrata e punës dhe në aktet relevante të UHZ, vendosjen e masave përkatëse e bën këshilli i njësisë akademike përkatëse.
3. Ndalesa e kompensimit pason paralajmërimet dhe vërejtje me shkrim dhe gojë, në rastet kur mësimdhënësi (profesori ose asistenti) nuk i përmbush obligimet e tij pa një arsye të bazuar dhe të pranueshme. Vendimi për ndalesën duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur plotësisht në prova të dokumentuara.
4. Për shkelje dhe mos përmbushje së vazhdueshme të detyrave të punës, do të zbatohet procedura disiplinore dhe masat e përcaktuara në pajtim me të gjitha aktet ligjore në fuqi.

## Neni 21

### Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja me nr. prot. 3162, datë 03.11.2023, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin “Haxhi Zeka”, si dhe aktet tjera të brendshme që rregullojnë çështje që trajtohen me këtë rregullore.
2. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca 1:
  - 2.1. Përmbajtja e Shtojca 1:
    - a. Kompensimi i personelit të rregullt akademik për orët shtesë të punës;
    - b. Kompensimi i personelit akademik të pensionuar (me mundësi të angazhimit deri në moshën 70 vjeçare);
    - c. Kompensimi i profesorit me titullin “Profesor Emeritus”;
    - ç. Fondi i orëve dhe kompensimi i personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, në cilësi të bashkëpunëtorëve të jashtëm;
    - d. Fondi i orëve dhe llogaritja e kompensimit të profesorëve vizitorë;
    - dh. Orët mësimore dhe kompensimi i ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike/praktike në programet studimore të akredituara;
    - e. Llogaritja e kompensimit për mentorin dhe anëtarin e komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës;
    - ë. Kompensimi për funksionet shtesë;
    - f. Kompensimi për detyrat dhe angazhimet si punë shtesë;
    - g. Kompensimi për mentorime.

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Këshilli i Drejtues i UHZ:

*Emine Abdyli*

Prof. Ass. Dr. Emine Abdyli, kryesuese



**SHTOJCA 1. Fondi i orëve mësimore (ligjërata dhe ushtrime) dhe lartësia e kompensimit të personelit akademik për orët shtesë, funksionet dhe angazhimet tjera**

**a. Kompensimi i personelit të regullt akademik për orët shtesë të punës**

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë mbi të cilën llogaritet puna shtesë deri në 30% të pagese sipas kalkulimeve të bëra për 4 orë në javë ligjërata	Përlllogaritja e çmimit për një orë ligjërata apo ushtrime	Totali mujor
1	Profesor asistent	4	16	1,254.00 €	23.51 €	376.20 €
2	Profesor i asociuar	4	16	1,364.00 €	25.58 €	409.20 €
3	Profesor i regullt	4	16	1,474.00 €	27.64 €	442.20 €
4	Asistent	6	24	902.00 €	11.28 €	270.60 €

**b. Kompensimi i personelit akademik të pensionuar (me mundësi të angazhimit deri në moshën 70 vjeçare)**

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë mbi të cilën llogaritet puna shtesë deri në 30%	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Profesor asistent	6	24	1,254.00 €	23.51 €	376.20 €
2	Profesor i asociuar	6	24	1,364.00 €	22.58 €	409.20 €
3	Profesor i regullt	6	24	1,474.00 €	27.64 €	442.20 €
4	Asistent	6	24	902.00 €	11.28 €	270.60 €

**c. Kompensimi i profesorit me titullin "Profesor Emeritus"**

Nr.	Titulli i nderit	Llogaritja e kompensimit	Totali mujor
1	Profesor Emeritus	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 20% se pagës bazë të profesorit të rregullt. Obligimet eventuale shtesë rregullohen me marrëveshje të veçantë.	€ 294.80

**ç. Fondi i orëve dhe kompensimi i personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, në cilësi të bashkëpunësorëve të jashtëm**

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Bashkëpunëtor i angazhuar për ligjërata	6	24	20.00 €	480.00 €
2	Bashkëpunëtor i angazhuar pa thirrje akademike për ligjërata	6	24	15.00 €	360.00 €
3	Bashkëpunëtor i angazhuar për ushtrime	10	40	10.00 €	400.00 €

**d. Fondi i orëve dhe llogaritja e kompensimit të profesorëve vizitor**

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Çmimi për orë	Totali mujor
1	Profesor vizitor për ligjërata (nga rajoni jashtë BE)	6	24	35.00 €	840.00 €
2	Profesor vizitor për ligjërata (vendet e BE)	6	24	60.00 €	1,440.00 €

dh. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike/praktike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka Universiteti ose njësitë akademike

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Kompensimi për orë	Totali mujor
1	Ekspert i praktikës në fushën perkatëse	Sipas syllabusit	Sipas syllabusit	20.00 €	480.00

e. Llogaritja e kompensimit për mentorin dhe anëtarët e komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Nr.	Emërtimi i komisionit/shërbimit	Kompensimi në vlerë bruto
1	Anëtar i komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës	400.00
2	Anëtar jo në rajon: Shpenzimet e qëndrimit deri në vlerë prej 300 €, në arsyetim me faturë origjinale	300.00
3	Anëtar jo në rajon: Shpenzimet e udhëtimit (bileta ose drejtëkalim) sipas çmimeve ekonomike, të arsyetuara me faturë origjinale	500.00
4	Anëtar në rajon (MNE, ALB, NM, SRB): Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit deri në vlerë prej 350 €, të arsyetuara me faturë origjinale	350.00

ë. Kompensimi për funksionet shtesë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Forma e llogaritjes së kompensimit
1	Rektor	20%	Kalkulimi sipas thirrjes akademike dhe specifkave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
2	Prorektor	18%	Kalkulimi sipas thirrjes akademike dhe specifkave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
3	Dekan	15%	Kalkulimi sipas thirrjes akademike dhe specifkave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
4	Prodekan	13%	Kalkulimi sipas thirrjes akademike dhe specifkave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
5	Shef departamenti në njësi akademike	10%	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të thirrjes akademike.
6	Kryesues i Këshillit Drejtues	30%	Llogaritja është bërë në lartësinë prej 30% të pagës bazë të ZKA.
7	Anëtar i Këshillit Drejtues	20%	Llogaritja është bërë në lartësinë prej 20% të pagës bazë të ZKA.

f. Kompensimi për detyrat dhe angazhimet si punë shtesë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Forma e llogaritjes së kompensimit
1	Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës	5%	Llogaritja e shtesës mujore në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesori asistent, për anëtarin që nuk është pjesë e UHZ.
2	Anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor	€ 250.00	Llogaritja fikse e kompensimit bëhet për anëtarin që nuk është pjesë e UHZ, vetëm për përtuhen e angazhimit sipas dinamikës së procesit zgjedhor.
3	Anëtar i KZF	€ 200.00	Llogaritja fikse e kompensimit bëhet për anëtarin që nuk është pjesë e UHZ, vetëm për përtuhen e angazhimit sipas dinamikës së procesit zgjedhor.
4	Drejtor i institutit		Llogaritja e kompensimit realizohet nga të hyrat e gjeneruara nga instituti përkatës.
5	Sekretar i institutit		Llogaritja e kompensimit realizohet nga të hyrat e gjeneruara nga instituti përkatës.
6	Ekspert në Qendrën e Ekselencës, për orë mësimi/trajnimi	€ 20.00	Llogaritja e kompensimit për orë e mësimi/trajnimit, nëse këto orë mbahen për staf që nuk është mbahen për staf të UHZ-së, kompensimi kryhet nga buxheti i UHZ-së, deri në 30% të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7	Ekspert në qendrat profesionale në nivel të Universitetit për orë mësimi/trajnimi	€ 20.00	Llogaritja e kompensimit për orë mësimi/trajnimi, Qendra gjeneron të hyra dhe si e tillë trajtohet si e hyrë e institutëve pasi është shërbim për ekonominë.

g. Kompensimi për mentorime

Nr.	Funksioni	Lartësia kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioneve ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
1	Mentor i disertacionit të doktoraturës		Llogaritja në lartësinë prej 8% të pagës bazë të Profesorit asistent. Kompensimi është kumulativ për 18 muaj dhe kompensohet pas mbrojtjes së punimit të doktoraturës. Brenda një viti akademik nuk mund të kompensohet më shumë se një mentorim.
2	Mentor në punimin e diplomës të studimeve master		Llogaritja në lartësinë prej 8% të pagës bazë të Profesorit asistent. Kompensimi bëhet për tri (3) mentorime gjatë një viti akademik, pasi të jetë plotësuar numri i sipas normës së rregullit. Norma e rregullit e mentorimeve, është tri (3) punime për vit akademik.